

Sekretarja e Përgjithshme e RCC Majlinda Bregu, Intervistë për Novi Magazin
E Enjte 5 Nëntor 2020
Fq. 24-27

Katër Liritë për Ballkanin Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor do të kenë së shpejti një samit rajonal në Sofje dhe një nga aktorët kryesorë në të është Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Sekretarja e Përgjithshme e RCC-së Majlinda Bregu, ish-profesore universiteti, anëtare partie, politike dhe ministre, ajo personalisht si dhe RCC luajtën një rol të rëndësishëm në korrik të vitit të kaluar në arritjen e një marrëveshje të përbashkët të ekonomive të rajonit për roaming, i cili është një hap i rëndësishëm për bashkëpunimin e mëtejshëm ekonomik, por edhe për qytetarët. Ne pyesim zonjën Bregu se kur dhe në cilat kushte mund të arrijmë standardet dhe statusin e BE-së në këtë fushë?

"Ju falënderoj për fjalët e mira. Ishte rezultat i përpjekjeve të kombinuara të një grupi ndërvepruesish, BE-së, 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe RCC-së. Po, ishte një arritje e madhe rajonale brenda Zonës Ekonomike Rajonale. Në të vërtetë Prillin e kaluar, gjatë Samitit të Dytë Digjital të Ballkanit Perëndimor, Ministrat nga të gjashtë vendet nënshkruan Marrëveshjen Rajonale të Roamingut, zbatimi i së cilës filloi në 1 korrik 2019, duke ulur në mënyrë drastike kostot e roamingut midis rajonit. Tashmë paguajmë nga 83 deri 96% më pak në tarifat e roamingut dhe që nga korriku 2021-shit kjo kosto do të jetë zero ", thotë Sekretarja e Përgjithshme e RCC për Novi Magazin.

Njëkohësisht, jemi duke punuar në uljen e çmimeve të roaming midis 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtarë të BE-së, pasi momentalisht për 100 MB dhe 30 minuta bisedë telefonike disa operatorë u faturojnë qytetarëve të BP nga 325 Euro deri në 609 Euro. Zbatimi i marrëveshjes sonë rajonale po monitorohet nga afër nga partnerët tanë të BE-së dhe jam e sigurt se sapo rajoni të vërë në zbatim marrëveshjen Rajonale dhe të eliminojë kostot e roamingut mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, BE do të respektojë angazhimin e vet dhe do nisë zvogëlimin gradual të kostove të roaming me vendet e rajonit. Është e rëndësishme

të theksohet se BE-së iu deshën 10 vjet për të arritur këtë rezultat për qytetarët e saj dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor vetëm 2 vjet të binin dakord mbi këtë angazhim."

Cilat janë planet, kur flitet për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal dhe cilat janë pritshmëritë tuaja nga Samiti i Sofjes?

Planet janë shumë ambicioze, por dua të besoj e të gjithë të biem dakord me këtë se janë gjithashtu realiste. Jam shumë optimiste lidhur me Samitin e Sofjes, duke besuar se do të biem dakord dhe do të ecim përpara për të krijuar Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM) i cili bazohet në qasjen e katër lirive - thelbi i propozimit të Mini-Shengenit dhe i përforcuar me investimet digjitale, inovatore industriale- duke pasqyruar parimet dhe rregullat e Tregut të Vetëm të BE-së.

Disa vlerësime të ekspertëve thonë se Ballkani Perëndimor do të përjetojë recesionin më të keq të dy dekadave të fundit. Dhe duket se tashmë ka filluar. BE-ja aktualisht ka bërë shumë për të zbutur ato pasoja në rajonin tonë. Plani i tyre i investimeve ekonomike (EIP) parashikon 9 miliardë euro në formë grantesh. Së bashku me 3.3 miliardë euro të akorduara tashmë për të luftuar shpërthimin e pandemisë, janë një shtysë për të ecur më shpejt me zhvillimin ekonomik.

Ky investim i BE-së, i mbështetur nga Western Balkans Guarantee Facility (Garantimi i Lehtësimit për Ballkanin Perëndimor) ka një potencial për të tërhequr 20 miliardë euro shtesë nga investimet publike dhe private. Kur i mbledh së bashku, shkojnë deri në 32.3 miliardë Euro për t'u futur në rajon - stimul masiv - pothuajse 30% e PBB-së prej 100 miliardë Eurosh të Ballkanit Perëndimor.

Ama Ballkani Perëndimor duhet të bëjë të vetën, të tregojë forcën e tij dhe këtu vijmë në Planin për Tregun e Përbashkët Rajonal që ecën përkrah me EIP-ën e BE-së. Ne jemi zonë shumë e vogël gjeografike me rreth 18 milionë njerëz në total. E megjithatë, pothuajse 50% e njerëzve në Ballkanin Perëndimor nuk kanë mundësi të barabarta për lëvizje të lirë, thjesht me ID Card. është një rajon me tregje që kanë rregulla e procedura të ndryshme. Qëllimi është sinkronizimi i këtyre tregjeve për të lejuar kalimin e qetë të mallrave, njerëzve, shërbimeve, kapitalit, por edhe për ta bërë të gjithë rajonin një destinacion tërheqës për investimet. Gjithashtu

duhet të kemi parasysh trendin global drejt digjitalizimit dhe të zhvillojmë plane për të adaptuar teknologjitë e reja në mënyrë që të jemi konkurrues.

Axhenda e gjelbër do të jetë gjithashtu një fokus i vëmendjes sonë në vitet e ardhshme, pasi mbështet të gjitha aspektet e jetesës. Një tjetër pikë e dobët e rajonit është “ikja e trurit”, veçanërisht e të rinjve. Në këtë pikë, rajoni ka pothuajse 5 mijë kërkesa për njohje ndërrajonale të diplomave akademike. Ne duhet ta bëjmë këtë proces më të lehtë. Duhet të veprojmë dhe të punojmë për t'i bërë shoqëritë tona tërheqëse për bizneset dhe për njerëzit që të qëndrojnë, të kontribuojnë dhe të punojnë në rajon, në vend që të largohen prej tij. Por, siç jeni të dijeni - Tregu i Përbashkët Rajonal nuk është një ide që e kemi nisur nga zero - zbatimi i tij bazohet mbi themelet e forta të hedhura mbi arritjet e mëparshme të Zonës Ekonomike Rajonale.

Të gjitha këto përpjekje synojnë të përmirësojnë jetën e qytetarëve, të krijojnë një mjedis më të shëndetshëm, punë më të denja dhe më të mirëpaguara, mundësi për fillestarët, veçanërisht për të rinjtë, udhëtime më të lehta, arsimim, lidhje më të forta, internet më të shpejtë, shërbime më të mira publike dhe konkurruese, rritja e vlerës së monedhave. Dhe sërish nuk mund të mos përmendim pandeminë - ajo vërtet vuri në dukje të gjitha pikat më të dobëta të shoqërive tona dhe faktin se nuk ka kohë ose hapësirë për të vepruar vetëm, pra individualisht, por që kemi nevojë për njëri-tjetrin për të ndarë si të mirën, ashtu edhe të keqen. Kjo na hapi sytë dhe krijoi gjithashtu një atmosferë vendosmërie midis partnerëve tanë për të vepruar. Dhe kjo është pikërisht ajo që më mbush me optimizëm.

Pandemia ka prishur të gjitha rrjedhat e rëndësishme të jetës si në nivel global ashtu edhe në atë lokal. RCC ka bërë shumë për të kapërcyer problemet jetësore në rajon, të cilat pandemia vetëm sa i ka përkeqësuar. Publiku di shumë pak për korridoret e gjelbra të krijura gjatë pandemisë. Deri në çfarë mase korridoret e gjelbra do të na lidhin me njëri-tjetrin dhe me Evropën dhe cilat do të veçonit si iniciativat më të rëndësishme?

Ashtu si shumë njerëz, shpërthimi i koronës na gjeti të pambrojtur. Por të gjithë kishim nevojë të përshtateshim shpejt dhe të gjenim një mënyrë për të jetuar dhe

punuar në këtë situatë 'të re normale' që do të vazhdojë për një të ardhme të paparashikueshme.

Ishte një moment gjatë izolimit kur paniku filloi të rritet ndërsa njerëzit po blinin më tepër, qofshin ato ushqime, ilaçe, letër higjienike madje, kufijtë u mbyllën një nga një, raporte pafund për të infektuarit, dhe ne po mendonim se çfarë mund të bënim, në vend që thjesht të prisnim të kalonte kjo stuhi. Prandaj, jam e kënaqur që qeveritë rajonale, BE-ja dhe partnerët tanë në CEFTA dhe Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Transportit pranuan me gjithë zemër idenë tonë për korridoret e gjelbra në BP për të lehtësuar kalimin e mallrave thelbësore si ushqimet dhe medikamentet mjekësore në rajonin tonë. Nuk ishte e dobishme për askënd që shoferët të prisnin më shumë se 20 orë në secilën nga pikat kufitare, 14 orë në vendet midis BP apo 18 në ato me BE-në. Çdo minutë e shoferit që pret në ato pika kufitare na kushton 2 Euro. Imagjinoni sa minuta apo euro të humbura janë ato. Dhe jo vetëm kaq. Në një pandemi, të jesh i shpejtë mund të nënkuptojë diferencën midis jetës dhe vdekjes.

Kështu që u mblodhëm shpejt dhe filluam të punojmë për këtë. Nuk ishte e lehtë. Asnjëherë nuk është e lehtë për të arritur një konsensus për diçka në rajon. Por ne, të gjithë së bashku, e bëmë atë në një kohë rekord. Sepse të gjithë e kuptuan urgjencën dhe rëndësinë. Jam e lumtur që funksionoi. Tashmë, si pjesë e Tregut të Përbashkët Rajonal, duam që rajoni të ketë kalime të përbashkëta kufitare, për të kursyer kohë dhe para. Është llogaritur që duke pasur të gjitha kalimet e përbashkëta kufitare brenda 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor që të funksionojnë 24/7, rajoni do të kursejë 800.000.000 euro në vit.

Sapo u emëruat Sekretare e Përgjithshme, juve u dërguat një mesazh grave të rajonit se zhvillimi i të gjitha shoqërive të rajonit varet kryesisht nga ato. Në ç` pikë janë gratë në rajon sot?

Sot, sipas Barometrit të fundit Ballkanik, përqindja e grave në punësimin e korporatave në Ballkanin Perëndimor është 38%. Akoma më dekurajues është fakti që vetëm 7% e drejtuesve të bizneseve të Ballkanit Perëndimor preferojnë të punësojnë një grua sesa një burrë. Nëse, nga ana tjetër, mbajmë parasysh që ekonomitë e Ballkanit Perëndimor humbin 5% të PBB-së për shkak të një hendeku

në pjesëmarrjen e grave si sipërmarrëse dhe PBB-ja e rajonit mund të jetë 20% më e lartë nëse gratë do të merrnin pjesë në tregun e punës në të njëjtat nivele siç bëjnë burrat, atëherë ky është një sinjal i qartë që mundësitë duhet të ndryshojnë.

Gratë janë forca më e fuqishme në botë dhe ne duhet të festojmë për ambiciet tona, të jetojmë në përputhje me aftësitë tona për të qenë vendimmarrëse, sipërmarrëse, për të përcaktuar rezultatet e zgjedhjeve në shoqëritë tona. Ne nuk mund të lejojmë të jemi thjesht lajm nëse jemi të suksesshme - suksesi i grave duhet të shndërrohet në histori të përditshme. Dhe mënyra e vetme për ta bërë këtë është të punojmë vazhdimisht dhe me gjithë zemër në fuqizimin e grave. Ne e kemi nisur këtë që nga RCC-ja, ku mbi 60% e punonjëseve tona janë gra, pothuajse të gjithë pozicionet udhëheqëse ushtrohen nga gratë. Fuqizimi i Gruas - Fushata WE është vetëm një hap në krijimin e një mjedisi ku gratë marrin drejtimin.

Përveç kësaj, ne promovojmë gratë në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM) dhe punojmë me gra që kanë punësuar gra të tjera, veçanërisht gjatë këtyre kohërave pandemike. Dhe të gjithë e dimë deri tani se sa sfiduese janë këto kohë - megjithatë gratë kanë arritur jo vetëm të mbajnë biznesin e tyre, por edhe t'i rritin këto biznese, ndërkaq në të njëjtën kohë mbajnë familjet të bashkara dhe mundohen të qëndrojnë optimiste. Nuk është një detyrë e lehtë, a s`mendoni kështu?

Unë nuk besoj se gratë, madje edhe në Ballkanin tradicional dhe patriarkal, kanë më pak të drejta sesa në pjesën tjetër të botës, por ajo për të cilën ne si një shoqëri e tërë duhet të punojmë është që ta ngrejme zërin, të jemi të qarta, kompetente dhe autoritare. Jo sepse është e drejta jonë por sepse është e drejtë.

Në karrierën tuaj të zgjeruar keni qenë profesore universiteti, Ministre për Integrimin Evropian, keni mbështetur reformën në drejtësi, megjithëse në atë kohë ishit ende anëtare partie. Si kapërcehen hendeqet midis karrierës universitare dhe asaj politike dhe midis partive të ndryshme opozitare? Pra, si arrihet konsensusi kur bëhet fjalë për interesat e përgjithshme?

Keni të drejtë. Më së shumti. Unë kam qenë të gjitha këto, dhe jo vetëm kaq. E lashë karrierën time akademike kur u përfshiva në politikë, sepse nuk mund t'i bëja

të dyja dhe urrej kur nuk mund t'i kushtoj vëmendjen e plotë që meriton puna ime. Plus që kisha një marrëdhënie të shkëlqyer me studentët. Unë jepja leksionet e kërkimit shkencor, e cila është shkencë natyrore, dhe studentëve që duan një diplomë në shkencat sociale nuk u pëlqen matematika apo statistika. Por ata kurrë nuk kanë humbur një leksion, pra nuk kanë munguar dhe as unë nuk mungoja kurrë. Kështu që nuk doja t'i zhgënjeja për sa i përket korrektësisë. Karriera politike u ndërpre papritur dhe ky nuk ishte vendimi im. Tani jam e përkushtuar në punën time, duke kryesuar RCC-në. Gjithsesi, në të gjitha këto ka emërues të përbashkët - Unë vazhdoj të praktikoj besimin tim në Evropë dhe rolin që BE mund të luajë në rajon, pasi unë jam një Evropiane e përkushtuar, dhe mund të ofrojë gjithashtu mundësi të barabarta si dhe përfshirjen e të gjitha grupeve shoqërore (përfshirë barazinë gjinore) në një mjedis të ndryshëm - tani edhe rajonalisht. Edhe pse besoj, gratë janë më të mirat.

Në fund të fundit njeriu duhet të jetë mjaft i përlurur dhe serioz që të mos mashtrojë veten. Të gjitha gratë përballen me beteja déjà vu, edhe pa një përvojë jetësore të luftës botërore në vazhdojmë të luftojmë çdo ditë, disa kanë punë të këqija, disa nuk janë fare në punë, disa kanë një punë të mirë dhe jetojnë përmes ndjenjës së pamëshirshme të të mos qenurit në shtëpi aq sa duhet, disa ndihen fajtoare pa ndonjë arsye konkrete, disa pyesin veten para një shefi mashkull, egoja e të cilit është e pakuptimtë nëse nuk gjen vërtet askënd tjetër për t'u mburrur, kështu që unë besoj se sinqerisht gratë duhet të mbështetin dhe vlerësojnë njëra-tjetrën. Personalisht nuk kam kohë që hipokrizia, truket, kuotat apo medaljet e nderit të varen si një perde në dhomën time të gjumit. Kaq e thjeshtë. Unë dua të jem e sigurt që zëri im pasqyron nevojat e njerëzve që unë përfaqësoj. Për të bërë një ndryshim, përmirësimin e një shoqërie dhe përmirësimin e jetës së njerëzve, qoftë përmes arsimit, qoftë përmes politikëbërjes në parlament, ose përmes zbatimit të politikave në qeveri.

Rinia është më e pafavorshme

Në fillim të këtij viti ju filluat një projekt kushtuar rinisë në rajon. A mund të na tregoni më shumë rreth kësaj? Si është situata me punësimin e të rinjve në rajon, veçanërisht në kontekstin e pandemisë? A punësoni të rinj?

Po, ne jemi shumë të lumtur të themi se rinia është pjesë e axhendës sonë. Të rinjtë janë grupi më vulnerabël i punësimit në rajonin tonë - papunësia e popullsisë së përgjithshme në rajon qëndron në 16%, ndërsa për të rinjtë është rreth 35%. Dhe pandemia e përkeqësoi situatën - numri i të rinjve të papunë është rritur me 27% që nga marsi i vitit 2020 kur u vunë re efektet e para të pandemisë, krahasuar me 15% rritje të papunësisë së regjistruar në përgjithësi. Kjo e çon numrin në gati 800 mijë të rinj të papunë - potencial i madh për zhvillimin e çdo shoqërie dhe një mal punësh për projektin tonë të ri.

Projekti ynë “Youth Lab” përqendrohet në motivimin e të rinjve për të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave që i shqetësojnë më së shumti. Kjo është në sfondin aktual të rajonit në të cilin kemi pothuajse një të katërtën (22.5%) të të rinjve plotësisht joaktivë - pra jo pjesë e arsimimit, punësimit ose trajnimit. Në krye të kësaj, një e treta e të rinjve të moshës 18-24 vjeç janë plotësisht të paimentuar për proceset vendimmarrëse të vendeve të tyre, shumë prej të cilave i prekin ata dhe për gjysmën e tyre nuk është as një temë për t'u diskutuar. Kështu që projekti Youth Lab është një përpjekje për të ndryshuar këtë panoramë - për t'u dhënë nxitje të rinjve që të përfshihen me autoritetet përkatëse për të formuluar politikën dhe aktivitetet në lidhje me ta.

Për të përfunduar me diçka pozitive - RCC është e lumtur të raportojë se është një organizatë që u jep një shans të rinjve. Ne i punësojmë ata sa herë që ekziston mundësia, kështu që vetëm në këtë vit, 14 të rinj i janë bashkuar organizatës tonë. Ata po bëjnë një punë të mirë, veçanërisht në rrethanat e punës hibride - pak në internet, pak nga zyra. Nuk është e lehtë, por të gjithë do ia dalim. Tani më shumë se 20% e RCC-së janë të rinj dhe unë jam shumë krenare për këtë.

Romët janë një potencial i madh

Beogradi mban prej vitesh Zyrën e Ekipit të Veprimit për Integrimin e Romëve të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal 2020. Si i vlerësoni rezultatet e integritit të Romëve deri më tani dhe a mendoni se po del në sipërfaqe fakti që Romët në të vërtetë janë një potencial për zhvillimin e shoqërive dhe rajoneve të tyre?

Në vitin 2016, Qeveria e Serbisë me mirësi u ofrua të mirëpresë zyrën tonë për Integrimin e Romëve, për të cilën ne jemi shumë mirënjohës. Kjo gjithashtu tregoi angazhimin e tyre për të punuar në përfshirjen e Romëve dhe kishte kuptim pasi Serbia ka komunitetin e dytë më të madh të Romëve, menjëherë pas Republikës së Maqedonisë së Veriut, me 147.604 Romë që jetojnë atje dhe që përfaqësojnë një total prej 2.05% të gjithë popullsisë. Këto janë të dhënat zyrtare në fakt, por mendohet se numrat janë shumë më të lartë, deri në 600 mijë. Përfshirja e romëve nuk sjell ndryshime pozitive vetëm për ta, por për të gjithë shoqërinë dhe ekonominë. 88% e romëve jetojnë në mungesë të rëndë materiale; 1 në 2 nuk është në gjendje të sigurojë ushqim në tryezë për çdo ditë; vetëm 16% janë të punësuar; dhe gati 10% nuk kanë ID Card. Ne jemi të kënaqur që iniciativa jonë për të rritur zhvillimin e kapitalit njerëzor brenda “Connectivity Agenda of Berlin Process” (Axhendës së Lidhjes së Procesit të Berlinit), duke përmirësuar konkretisht dimensionin e tyre social, është një realitet.

Vitin e kaluar, ne propozuam Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve, që përcakton synime të rëndësishme që qeveritë të arrijnë para se të mund të bashkohen BE-së dhe kjo u bë shumë shpejt një anije e integritit të Romëve në rajon. Dhe gjithashtu, Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, nisur disa javë më parë, përforcon angazhimin e BE-së për të mbështetur përpjekjet e Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar tregun e punës dhe arsimin digjital të grupeve në disavantazh, përfshirë Romët.